**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e pranimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Valmirë Deliu** | **03.03.2025** | **12.03.2025** | **2025/0140** |

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.02.2025, **OE "" AUTOTRADE " SH.P.K.**"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0140, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"FURNIZIMI ME PJESË PËR AUTOMJETET TOYOTA LAND CRUSER 150 -Ritender"** me nr. të prokurimit: "**214-24-9697-1-1-1**", iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurën e hapur**, lloji i kontratës: **furnizim,** vlera e parashikuar e kontratës: **500,000.00 €.**

Shënim: *Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më **Nr. 2024/1195 i dt: 28.01.2025**.*

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

**Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:**

- Neni 1 i LPP-së
- Neni 6 i LPP-së.
- Neni 7 i LPP-së
- Neni 52 i LPP-së
- Neni 59 i LPP-së

- Neni 60 i LPP-së
- Neni 62 i LPP-së
- Neni 72 i LPP-së
- Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.
- Neni 43 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.
- Neni 4 i Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022.

**Pikat kryesore të ankesës**

1. Rivlerësimi i ofertës – AK ka ndryshuar vlerësimin fillestar, duke eliminuar ofertuesin pa bazë ligjore.
2. Arsye e paargumentuar për eliminim – AK pretendon se çmimet janë mbi tregun, por paofruar prova ose krahasime me çmime reale të pjesëve origjinale.
3. Mungesa e analizës së tregut – Nuk është bërë një analizë e mirëfilltë për të verifikuar çmimet e tregut për pjesët origjinale.
4. Shkelja e procedurave të rivlerësimit – OSHP kishte vendosur për rivlerësim, por AK sërish ka anuluar aktivitetin pa justifikim të saktë.
5. Diskriminim dhe trajtim i pabarabartë – Ankuesi pretendon se ka pasur trajtim të pabarabartë nga AK, duke favorizuar operatorë të tjerë.
6. Mungesa e transparencës – AK nuk ka ofruar dokumentacion ose prova mbi vlerësimet e tij për çmimet e tregut.
7. Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është marrë shumë shpejt – Indikacion për mungesë të shqyrtimit serioz nga AK.

Në bazë të këtyre pikave, ankuesi kërkon anulimin e vendimit të AK dhe kthimin e çështjes në rivlerësim konform dispozitave ligjore të LPP-së. Për më tepër, përmbajtja e detajuar e pretendimeve dhe argumenteve ligjore të ankuesit mund të gjendet në ankesën e dorëzuar pranë OSHP-së.

KRITERET PËR VLERËSIM

Pretendimet ankimore nuk lidhen me kriteret e përcaktuara në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FDT), por me çmimet më të larta se ato të tregut, të pretenduara nga Autoriteti Kontraktues dhe të ofruara nga ankuesi, çka ka çuar në eliminimin e tij. Për më shumë detaje mbi pretendimet e ngritura dhe bazën e tyre ligjore, ju lutemi t'i referoheni ankesës së bashkëngjitur.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

**PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN , VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE**

**Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative teknike profesionale:**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë " Buqa " 600165866 | OE eshë i papërgjegjshëm sipas vendimit te OSHP-se me numër 2024/1195 te datës 28.01.2025 |
| 2. | " AUTOTRADE " SH.P.K. 600289260 | OE është i papërgjegjshëm për pikat ne vijim:<br>• Sipas nenit 4.1 pikës C të rregullore nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik cila thotë Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut ju keni ofruar me çmime shumë herë me te lart se sa çmimet reale te tregut për artikullin.<br>• Pjesa A: Pz.1, Pz.3, Pz.9, Pz.10, Pz.11, Pz.12, Pz.13, Pz.14, Pz.15, Pz.20.<br>• Pjesa B: Pz.25, Pz.29, Pz.32, Pz.33, Pz.35, Pz.36, Pz.41, Pz.42, Pz.43, Pz.46, Pz.50, Pz.51, Pz.52, Pz.59, Pz.60, Pz.68, 89, Pz.90, Pz.99, Pz.100, Pz.101, Pz.102, Pz.105, Pz.106, Pz.107, Pz.112, Pz.113, Pz.114, Pz.129, Pz.132, Pz.133, Pz.135, Pz.137, Pz.140, Pz.141, Pz.143, Pz.144, Pz.145, Pz.147, Pz.148, Pz.150, Pz.154, Pz.157.<br>• Pjesa C: Pz.159, Pz.160, Pz.162, Pz.163, Pz.164, Pz.166, Pz.167, Pz.171, Pz.172, Pz.175, Pz.176, Pz.177, Pz.178, Pz.182, Pz.185, Pz.188, Pz.189, Pz.190, Pz.191, Pz.200, Pz.201, Pz.202, Pz.203, Pz.204, Pz.205, Pz.210, Pz.211, Pz.218, Pz.220, Pz.228, Pz.229 |

| Furnizim dhe montim me pjesë për automjetet Toyota 150 të PK-së | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TIPI I AUTOMJETIT: TOYOTA LAND CRUISER 150 ,VITI I PRODHIMIT 2019-2022 | | | | | | | |
| Nr | Pershkrimi | Njësia | Sasia | Çmimi njësi me TVSH te palnifikaura AK | Çmimi njësi me TVSH nga AUTOTRADE | Diferenca ne Euro | Diferenca ne % |
| Pjesa-A 50% | | | | | | | |
| 1 | Filteri I vajit | copë | 1 | 11.00 | 16.70 | 5.70 | 51.82 |
| 3 | Filteri I naftës | copë | 1 | 35.00 | 65.00 | 30.00 | 85.71 |
| 9 | Fshisat e para | set | 1 | 37.00 | 51.50 | 14.50 | 39.19 |
| 10 | Fshisa e xhamit të pasem | copë | 1 | 8.00 | 19.90 | 11.90 | 148.75 |
| 11 | Cilindri i frenave te para-RH | copë | 1 | 305.00 | 469.90 | 164.90 | 54.07 |
| 12 | Cilindri i frenave te para-LH | copë | 1 | 305.00 | 469.90 | 164.90 | 54.07 |
| 13 | Cilindri i frenave te pasme -RH | copë | 1 | 170.00 | 474.00 | 304.00 | 178.82 |
| 14 | Cilindri i frenave te pasme -LH | copë | 1 | 170.00 | 474.00 | 304.00 | 178.82 |
| 15 | Gypi I metalt I frenave ne cilinder të rrotes së parë | copë | 1 | 5.50 | 9.00 | 3.50 | 63.64 |
| 20 | Semeringu i kushinetes se rrotesë se parë | copë | 1 | 14.00 | 48.20 | 34.20 | 244.29 |
| Totali i Pjesës A | | | | 1,060.50 | 2,098.10 | 1,037.60 | |
| Pjesa-B 30% | | | | | | | |
| 25 | Gomina e pirunit të poshtem No.1 | copë | 1 | 53.00 | 77.50 | 24.50 | 46.23 |
| 29 | Spon e mrenshme (kaqiku) | copë | 1 | 162.00 | 249.60 | 87.60 | 54.07 |
| 32 | Nyja e mbrensheme e gjysemboshtit te parë | copë | 1 | 267.00 | 410.00 | 143.00 | 53.56 |
| 33 | Gjysem boshti (zgllobi) komplet I parë | copë | 1 | 539.00 | 687.20 | 148.20 | 27.50 |
| 35 | Manzheta të nyjeve së jashtme të zgllobit | copë | 1 | 101.00 | 135.00 | 34.00 | 33.66 |
| 36 | Gjysem boshti I pasem | copë | 1 | 349.00 | 528.50 | 179.50 | 51.43 |
| 41 | Piruni i eperm- LH-RH | copë | 1 | 231.00 | 339.00 | 108.00 | 46.75 |
| 42 | Piruni I poshtëm-LH-RH | copë | 1 | 231.00 | 417.00 | 186.00 | 80.52 |
| 43 | Karteri i hekurt i vogel | copë | 1 | 80.00 | 420.00 | 340.00 | 425.00 |
| 46 | Mbajtes i brushave të alternatorit | copë | 1 | 17.00 | 960.00 | 943.00 | 5,547.06 |
| 50 | Alternator (xheneratori) | copë | 1 | 591.00 | 1,030.00 | 439.00 | 74.28 |
| 51 | Starteri (Anllaseri) | copë | 1 | 390.00 | 700.00 | 310.00 | 79.49 |
| 52 | Injector (dizene) | copë | 1 | 321.00 | 898.00 | 577.00 | 179.75 |
| 59 | Ftofes I vajit | copë | 1 | 267.00 | 820.50 | 553.50 | 207.30 |
| 60 | Zhive e flutres motorit komplet me fluter | copë | 1 | 238.00 | 425.00 | 187.00 | 78.57 |
| 68 | Interkoler | copë | 1 | 492.00 | 614.00 | 122.00 | 24.80 |
| 69 | Gyp I ajrit No1 I interkullerit | copë | 1 | 67.00 | 49.90 | -17.10 | -25.52 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 89 | Shtepiza (gllavqina) parë-RH | copë | 1 | 318.00 | 582.00 | 264.00 | 83.02 |
| 90 | Shtepiza (gllavqina) parë-LH | copë | 1 | 318.00 | 582.00 | 264.00 | 83.02 |
| 99 | Blloku i motorit(Komplet) | copë | 1 | 2,767.00 | 14,000.00 | 11,233.00 | 405.96 |
| 100 | Turbina | copë | 1 | 1,307.00 | 2,990.00 | 1,683.00 | 128.77 |
| 101 | Ndrrusi i shpejtesive me 6-shpejesi(manual) | copë | 1 | 4,710.00 | 7,000.00 | 2,290.00 | 48.62 |
| 102 | Ndrrusi I shpejtesive automatik | copë | 1 | 4,710.00 | 9,770.00 | 5,060.00 | 107.43 |
| 105 | Reduktori Komplet | copë | 1 | 1,866.00 | 4,110.00 | 2,244.00 | 120.26 |
| 106 | Diferenciali i parë | copë | 1 | 893.00 | 2,120.00 | 1,227.00 | 137.40 |
| 107 | Diferenciali i mramë | copë | 1 | 1,148.00 | 3,520.00 | 2,372.00 | 206.62 |
| 112 | Nderpres I 4 tregusve | copë | 1 | 48.00 | 633.20 | 585.20 | 1,219.17 |
| 113 | Pull e ndezjesë | copë | 1 | 114.00 | 180.00 | 66.00 | 57.89 |
| 114 | Raket e fshisave | copë | 1 | 83.00 | 140.00 | 57.00 | 68.67 |
| 129 | Semering i deferencialit te parë 1 | copë | 1 | 17.00 | 39.00 | 22.00 | 129.41 |
| 132 | Gypi i kokesë se timonit me presion të lartë | copë | 1 | 360.00 | 475.00 | 115.00 | 31.94 |
| 133 | Ventilator i ftohsit te AC | copë | 1 | 430.00 | 589.00 | 159.00 | 36.98 |
| 135 | Gyp I klimes No.2 | copë | 1 | 98.00 | 380.00 | 282.00 | 287.76 |
| 137 | Gyp I EGR së | copë | 1 | 357.00 | 94.00 | -263.00 | -73.67 |
| 140 | Nderprersi kryesor I xhamave | copë | 1 | 278.00 | 405.00 | 127.00 | 45.68 |
| 141 | Komprosor I Klimes | copë | 1 | 543.00 | 783.00 | 240.00 | 44.20 |
| 143 | Kompjuteri i dirigjusëve të dyrve | copë | 1 | 470.00 | 1,060.00 | 590.00 | 125.53 |
| 145 | Kompjuteri i Motorrit | copë | 1 | 256.00 | 950.00 | 694.00 | 271.09 |
| 147 | Koka e timonit | copë | 1 | 1,165.00 | 1,560.00 | 395.00 | 33.91 |
| 148 | Bandash i aluminit | copë | 1 | 430.00 | 575.00 | 145.00 | 33.72 |
| 150 | Partikell filteri -DPF | copë | 1 | 1,167.00 | 1,755.00 | 588.00 | 50.39 |
| 154 | Senzor DPF No.4 | copë | 1 | 210.00 | 330.00 | 120.00 | 57.14 |
| 157 | Gypi I furnizimit me nxems I AD BLU-së | copë | 1 | 45.00 | 340.00 | 295.00 | 655.56 |
| | **Totali i Pjesës B** | | | **28,504.00** | **63,723.40** | **35,219.40** | **123.56** |
| | Pjesa C 20% | | | | | | |
| 159 | Mbrojtesi I pare pa sterpikse të ujit | copë | 1 | 295.00 | 437.00 | 142.00 | 48.14 |
| 160 | Mbrojtesi I pare me sterpikse të ujit | copë | 1 | 295.00 | 460.00 | 165.00 | 55.93 |
| 162 | Parafango pa senzor | copë | 1 | 487.00 | 730.00 | 243.00 | 49.90 |
| 163 | Maska dekoruese | copë | 1 | 43.00 | 530.00 | 487.00 | 1,132.56 |
| 164 | Dritat të para-LH-RH | copë | 1 | 290.00 | 745.00 | 455.00 | 156.90 |
| 166 | Rrjeti I mesëm në mbrojts të parë | copë | 1 | 30.00 | 75.00 | 45.00 | 150.00 |
| 167 | Rrjeti I hallogenit LH,RH me krom | copë | 1 | 20.00 | 75.00 | 55.00 | 275.00 |
| 171 | Hauba | copë | 1 | 371.00 | 820.00 | 449.00 | 121.02 |
| 172 | Krahu I parë-LH-RH | copë | 1 | 212.00 | 380.00 | 168.00 | 79.25 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 175 | Retrovizor komplet-LH-RH | copë | 1 | 286.00 | 470.50 | 184.50 | 64.51 |
| 176 | Dyer të para-LH-RH | copë | 1 | 388.00 | 908.00 | 520.00 | 134.02 |
| 177 | Dyer të mrama-LH-RH | copë | 1 | 365.00 | 595.00 | 230.00 | 63.01 |
| 178 | Xhama të dyerve të para-LH-RH | copë | 1 | 133.00 | 240.00 | 107.00 | 80.45 |
| 182 | Krahu I mramë-LH-RH | copë | 1 | 212.00 | 585.00 | 373.00 | 175.94 |
| 185 | Mbrojtesi I mramë | copë | 1 | 288.00 | 492.00 | 204.00 | 70.83 |
| 188 | Dera e pestë | copë | 1 | 450.00 | 1,095.00 | 645.00 | 143.33 |
| 189 | Xhami I derës së pestë | copë | 1 | 320.00 | 555.00 | 235.00 | 73.44 |
| 190 | Spojleri në derë të pestë | copë | 1 | 40.00 | 614.00 | 574.00 | 1,435.00 |
| 191 | Brava të dyerve të jashtme të para-LH-RH | copë | 1 | 25.00 | 227.00 | 202.00 | 808.00 |
| 200 | Ftofes I ujit | copë | 1 | 175.00 | 380.00 | 205.00 | 117.14 |
| 201 | Flutra e ftofsit të klimes | copë | 1 | 309.00 | 680.00 | 371.00 | 120.06 |
| 202 | Brava të mbrendshme të dyrve të para-LH-RH | copë | 1 | 25.00 | 138.00 | 113.00 | 452.00 |
| 203 | Brava të mbrendshme të dyrve të mrama-LH-RH | copë | 1 | 25.00 | 134.00 | 109.00 | 436.00 |
| 204 | Kufizues të dyrve të para-LH-RH | copë | 1 | 15.00 | 96.00 | 81.00 | 540.00 |
| 205 | Kufizues të dyrve të mrama-LH-RH | copë | 1 | 15.00 | 96.00 | 81.00 | 540.00 |
| 210 | Brava e jashtme e deres së pestë | copë | 1 | 25.00 | 133.50 | 108.50 | 434.00 |
| 211 | Brava e brendshme e deres së pestë | copë | 1 | 25.00 | 125.00 | 100.00 | 400.00 |
| 218 | Shini I mbrojtesit të parë | copë | 1 | 67.00 | 264.00 | 197.00 | 294.03 |
| 220 | Instrument tabela(shalltabell) | copë | 1 | 947.00 | 1,195.00 | 248.00 | 26.19 |
| 228 | Karrika e shoferit | copë | 1 | 1,815.00 | 2,440.00 | 625.00 | 34.44 |
| 229 | Karrika e pasaxherit | copë | 1 | 1,815.00 | 2,440.00 | 625.00 | 34.44 |
| | **Totali i Pjesës C** | | | **9,808.00** | **18,155.00** | **8,347.00** | |
| | | | | | | 44,604.00 | |

Nese AK lidh kontrat me keto çper sasin 1 per artikujt e larte shenuar do te paguente 44,604.00 euro me shtrehjt se sa planifkimi i AK

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" AUTOTRADE " SH.P.K.**

**ANALIZA E EKSPERTIT SHQYRTUES**

Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit dhe vendimet e AK-së, duke paraqitur konstatimet dhe vlerësimet e tij si më poshtë:

**Pretendimi Ankimor 1**

Operatori Ekonomik AUTOTRADE SH.P.K. kundërshton vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) për eliminimin e ofertës së tij, duke e konsideruar të pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore. Fillimisht, AK e shpalli ankuesin të pasuksesshëm, ndërsa pas rivlerësimit e eliminoi me pretendimin se çmimet e tij ishin mbi tregun, pa ofruar një analizë të qartë dhe të verifikueshme për këtë konstatim.

Ankuesi thekson se çmimet e tij janë bazuar në burime zyrtare të Toyota-s dhe për pjesët origjinale nuk ka mundësi të ketë çmime më të ulëta, ndërsa AK nuk ka kryer analizë reale të tregut dhe nuk ka paraqitur prova mbi bazën e vlerësimit të tij. Diferenca prej 44,694 € në krahasimet e bëra nga AK në çmime lidhet kryesisht me pozicione specifike si motori, ndërruesi dhe turbina, të cilat përbëjnë 63% të ndryshimit. Për të dëshmuar vlefshmërinë e ofertës së tij, ankuesi ka siguruar referenca për motorë të ngjashëm nga Volkswagen dhe ofertë nga Toyota Ljubljana.

Ankuesi po ashtu ka theksuar se pavarësisht dështimit të fazës së parë të tenderit, AK nuk ka bërë analizë të mirëfilltë të çmimeve dhe ka krahasuar ofertën e ankuesit me vlera të vendosura nga vetë ai pa një bazë të qartë. Referimi në Rregulloren Nr.002/2024, Neni 4.1, pika C, nuk është i aplikueshëm, pasi AK nuk ka ofruar prova që tregojnë se çmimi i ofertës është më i lartë se çmimi i tregut.

Duke qenë se AK nuk ka kryer një analizë objektive dhe nuk ka ofruar dëshmi për vlerësimin e çmimeve, ankuesi kërkon shfuqizimin e vendimit të eliminimit dhe rivlerësimin e ofertave në përputhje me kërkesat ligjore.

**Kronologjia dhe Shkeljet e Konstatuara nga OSHP-ja**

Në vlerësimin fillestar të ofertave, AK – Policia e Kosovës rekomandoi për kontratë OE – Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë "Buqa". Pas këtij vendimi, OE - AUTOTRADE SH.P.K. paraqiti një ankesë pranë OSHP-së, duke potencuar se OE "Buqa" nuk kishte paraqitur autorizimin e prodhuesit, ndonëse ky dokument ishte kriter i përcaktuar në Dosjen e Tenderit (FDT).

Pas shqyrtimit të ankesës, Paneli Shqyrtues i OSHP-së konstatoi se OE "Buqa" nuk e kishte përmbushur këtë kërkesë dhe vendosi që lënda të kthehej për rivlerësim. Në këtë fazë të

procesit, AK e vlerësoi OE AUTOTRADE SH.P.K. si të pasuksesshëm.
Në vendimin e tij, OSHP kërkoj nga që AK të kryejë rivlerësimin e ofertave në përputhje me kriteret e përcaktuara në LPP dhe në dokumentet e tenderit, duke siguruar një proces të drejtë dhe të bazuar në prova konkrete.

**Përgjigje në Pretendimin Ankimor 1**

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i ankuesit për eliminimin dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit është i bazuar, pasi AK nuk ka kryer një analizë të plotë të çmimeve të tregut, ka referuar njëanshëm çmimet e njësisë kërkuese.
Eksperti vlerëson se, AK është dashur të mbështesë eliminimin e ofertës mbi një analizë të thelluar dhe gjithëpërfshirëse të tregut, e jo vetëm në çmimet e njësisë kërkuese. Për këtë arsye, eksperti shqyrtues rekomandon që të bëhet rivlerësimi i ofertave, duke siguruar që vendimet mbi çmimet të bazohen në analiza objektive dhe një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

**Pretendimi Ankimor 2**

Shkelja e dispozitave ligjore për transparencë dhe trajtim të barabartë të OE-ve. Ankuesi pretendon se AK ka vepruar në mënyrë të njëanshme dhe diskriminuese, duke mos i trajtuar operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë, në kundërshtim me Nenin 7 të LPP-së, i cili kërkon që AK të veprojë në mënyrë të barabartë dhe transparente ndaj të gjithë ofertuesve.
Sipas ankuesit AK nuk ka siguruar prova objektive mbi çmimet e tregut për pjesët origjinale Toyota, ka përdorur kriteret e vlerësimit në mënyrë selektive, dhe nuk ka ofruar asnjë informacion mbi bazën e analizës së tij për çmimet e tregut. Ankuesi kërkon shfuqizimin e vendimit të AK-së dhe rivlerësimin transparent të ofertave sipas standardeve ligjore.

**Përgjigje në Pretendimin Ankimor 2**

Eksperti shqyrtues ka analizuar dokumentacionin e tenderit në platformën e-prokurimi dhe ka vërejtur dallime në trajtimin e operatorëve ekonomikë nga ana e AK-së. Ndërsa OE "Buqa" ka pasur mundësinë të ofrojë sqarime për disa çmime, të cilat janë pranuar nga AK, për AUTOTRADE SH.P.K., pavarësisht se ka ofruar sqarime në përputhje me kërkesën e AK-së, nuk është aplikuar e njëjta qasje.
Pretendimi ankimor konsiderohet i bazuar, pasi dokumentet e shqyrtuara tregojnë se qasja e AK-së në vlerësimin e operatorëve ekonomikë nuk ka qenë e njëtrajtshme, gjë që mund të ketë ndikuar në objektivitetin dhe transparencën e procesit të vlerësimit.
*Dokumentin me analizën e çmimeve të operatorëve ekonomikë, krahasimin me njësinë kërkuese dhe çmimet e kontestuara për AUTOTRADE SH.P.K. të analizuar nga eksperti shqyrtues e gjeni më poshtë:*

| Nr | Pershkrimi | Niësia | Sasia | Cmimi njësi me TVSH nga Autotrade | Cmimi njësi me TVSH nga "Buqa" | Cmimi njësi me TVSH i planifikuar nga AK |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Filteri I vajit | copë | 1 | 16.70 | 15.00 | 11.00 |
| 3 | Filteri I naftës | copë | 1 | 65.00 | 55.00 | 35.00 |
| 9 | Fshisat e para | set | 1 | 51.50 | 35.00 | 37.00 |
| 10 | Fshisa e xhamit të pasem | copë | 1 | 19.90 | 5.00 | 8.00 |
| 11 | Cilindri i frenave te para-RH | copë | 1 | 469.90 | 310.00 | 305.00 |
| 12 | Cilindri i frenave te para-LH | copë | 1 | 469.90 | 310.00 | 305.00 |
| 13 | Cilindri i frenave te pasme -RH | copë | 1 | 474.00 | 265.00 | 170.00 |
| 14 | Cilindri i frenave te pasme -LH | copë | 1 | 474.00 | 265.00 | 170.00 |
| 15 | Gypi I metalt I frenave ne cilinder të rrotes së parë | copë | 1 | 9.00 | 5.00 | 5.50 |
| 20 | Semeringu i kushinetes se rrotesë se parë | copë | 1 | 48.20 | 15.00 | 14.00 |
| 25 | Gomin e pirunit të poshtem No.1 | copë | 1 | 77.50 | 65.00 | 53.00 |
| 29 | Spon e mrenshme (kagiku) | copë | 1 | 249.60 | 160.00 | 162.00 |
| 32 | Nyja e mbrensheme e givsemboshtit te parë | copë | 1 | 410.00 | 325.00 | 267.00 |
| 33 | Givsem boshti (zgllobi) komplet I parë | copë | 1 | 687.20 | 588.00 | 539.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 35 | Manzheta të nyjeve së jashtme të zgllobit | copë | 1 | 135.00 | 70.00 | 101.00 |
| 36 | Gjysem boshti I pasem | copë | 1 | 528.50 | 429.00 | 349.00 |
| 41 | Piruni i eperm-LH-RH | copë | 1 | 339.00 | 285.00 | 231.00 |
| 42 | Piruni I poshtëm-LH-RH | copë | 1 | 417.00 | 350.00 | 231.00 |
| 43 | Karteri i hekurt i vogel | copë | 1 | 420.00 | 75.00 | 80.00 |
| 46 | Mbajtes i brushave të alternatorit | copë | 1 | 960.00 | 15.00 | 17.00 |
| 50 | Alternator (xheneratori) | copë | 1 | 1030.00 | 800.00 | 591.00 |
| 51 | Starteri (Anllaseri) | copë | 1 | 700.00 | 550.00 | 390.00 |
| 52 | Injector (dizene) | copë | 1 | 898.00 | 650.00 | 321.00 |
| 59 | Ftofes I vajit | copë | 1 | 820.50 | 567.00 | 267.00 |
| 60 | Zhive e flutres motorit komplet me fluter | copë | 1 | 425.00 | 362.00 | 238.00 |
| 68 | Interkoler | copë | 1 | 614.00 | 480.00 | 492.00 |
| 69 | Gyp I airit No1 I interkullerit | copë | 1 | 49.90 | 45.00 | 67.00 |
| 89 | Shtepiza (gllavgina) parë-RH | copë | 1 | 582.00 | 395.00 | 318.00 |
| 90 | Shtepiza (gllavgina) parë-LH | copë | 1 | 582.00 | 395.00 | 318.00 |
| 99 | Blloku i motorit(Komplet) | copë | 1 | 14000.00 | 3490.00 | 2767.00 |
| 100 | Turbina | copë | 1 | 2990.00 | 2200.00 | 1307.00 |
| 101 | Ndrrusi i shpejtesive me 6-shpejesi(manual) | copë | 1 | 7000.00 | 5950.00 | 4710.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 102 | Ndrrusi I shpejtesive automatik | copë | 1 | 9770.00 | 6455.00 | 4710.00 |
| 105 | Reduktori Komplet | copë | 1 | 4110.00 | 2900.00 | 1866.00 |
| 106 | Diferenciali i parë | copë | 1 | 2120.00 | 1700.00 | 893.00 |
| 107 | Diferenciali i mramë | copë | 1 | 3520.00 | 2800.00 | 1148.00 |
| 112 | Nderpres I 4 tregusve | copë | 1 | 633.20 | 45.00 | 48.00 |
| 113 | Pull e ndezjesë | copë | 1 | 180.00 | 95.00 | 114.00 |
| 114 | Raket e fshisave | copë | 1 | 140.00 | 87.00 | 83.00 |
| 129 | Semering i deferencialit te parë 1 | copë | 1 | 39.00 | 15.00 | 17.00 |
| 132 | Gypi i kokesë se timonit me presion të lartë | copë | 1 | 475.00 | 280.00 | 360.00 |
| 133 | Ventilator i ftohsit te AC | copë | 1 | 589.00 | 520.00 | 430.00 |
| 135 | Gyp I klimes No.2 | copë | 1 | 380.00 | 115.00 | 98.00 |
| 137 | Gyp I EGR së | copë | 1 | 94.00 | 147.00 | 357.00 |
| 140 | Nderprersi kryesor I xhamave | copë | 1 | 405.00 | 200.00 | 278.00 |
| 141 | Komprosor I Klimes | copë | 1 | 783.00 | 650.00 | 543.00 |
| 143 | Kompjuteri i dirigjusëve të dyrve | copë | 1 | 1060.00 | 350.00 | 470.00 |
| 145 | Kompjuteri i Motorrit | copë | 1 | 950.00 | 600.00 | 256.00 |
| 147 | Koka e timonit | copë | 1 | 1560.00 | 1320.00 | 1165.00 |
| 148 | Bandash i aluminit | copë | 1 | 575.00 | 400.00 | 430.00 |
| 150 | Partikell filteri - DPF | copë | 1 | 1755.00 | 1300.00 | 1167.00 |
| 154 | Senzor DPF No.4 | copë | 1 | 330.00 | 250.00 | 210.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 157 | Gypi I furnizimit me nxems I AD BLU-së | copë | 1 | 340.00 | 278.00 | 45.00 |
| 159 | Mbrojtesi I pare pa sterpikse të ujit | copë | 1 | 437.00 | 385.00 | 295.00 |
| 160 | Mbrojtesi I pare me sterpikse të ujit | copë | 1 | 460.00 | 399.00 | 295.00 |
| 162 | Parafango pa senzor | copë | 1 | 730.00 | 490.00 | 487.00 |
| 163 | Maska dekoruese | copë | 1 | 530.00 | 445.00 | 43.00 |
| 164 | Dritat të para-LH-RH | copë | 1 | 745.00 | 696.00 | 290.00 |
| 166 | Rrieti I mesëm në mbrojts të parë | copë | 1 | 75.00 | 60.00 | 30.00 |
| 167 | Rrieti I hallogenit LH,RH me krom | copë | 1 | 75.00 | 60.00 | 20.00 |
| 171 | Hauba | copë | 1 | 820.00 | 595.00 | 371.00 |
| 172 | Krahu I parë-LH-RH | copë | 1 | 380.00 | 272.00 | 212.00 |
| 175 | Retrovizor komplet-LH-RH | copë | 1 | 470.50 | 350.00 | 286.00 |
| 176 | Dyer të para-LH-RH | copë | 1 | 908.00 | 800.00 | 388.00 |
| 177 | Dyer të mrama-LH-RH | copë | 1 | 595.00 | 500.00 | 365.00 |
| 178 | Xhama të dyerve të para-LH-RH | copë | 1 | 240.00 | 180.00 | 133.00 |
| 182 | Krahu I mramë-LH-RH | copë | 1 | 585.00 | 223.00 | 212.00 |
| 185 | Mbrojtesi I mramë | copë | 1 | 492.00 | 400.00 | 288.00 |
| 188 | Dera e pestë | copë | 1 | 1095.00 | 950.00 | 450.00 |
| 189 | Xhami I derës së pestë | copë | 1 | 555.00 | 500.00 | 320.00 |
| 190 | Spoileri në derë të pestë | copë | 1 | 614.00 | 50.00 | 40.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 191 | Brava të dverve të jashtme të para-LH-RH | copë | 1 | 227.00 | 30.00 | 25.00 |
| 200 | Ftofes I ujit | copë | 1 | 380.00 | 170.00 | 175.00 |
| 201 | Flutra e ftofsit të klimes | copë | 1 | 680.00 | 300.00 | 309.00 |
| 202 | Brava të mbrendshme të dyrve të para-LH-RH | copë | 1 | 138.00 | 27.00 | 25.00 |
| 203 | Brava të mbrendshme të dyrve të mrama-LH-RH | copë | 1 | 134.00 | 27.00 | 25.00 |
| 204 | Kufizues të dyrve të para-LH-RH | copë | 1 | 96.00 | 77.00 | 15.00 |
| 205 | Kufizues të dyrve të mrama-LH-RH | copë | 1 | 96.00 | 77.00 | 15.00 |
| 210 | Brava e jashtme e deres së pestë | copë | 1 | 133.50 | 110.00 | 25.00 |
| 211 | Brava e brendshme e deres së pestë | copë | 1 | 125.00 | 110.00 | 25.00 |
| 218 | Shini I mbroitesit të parë | copë | 1 | 264.00 | 70.00 | 67.00 |
| 220 | Instrument tabela(shalltabell) | copë | 1 | 1195.00 | 917.00 | 947.00 |
| 228 | Karrika e shoferit | copë | 1 | 2440.00 | 970.00 | 1815.00 |
| 229 | Karrika e pasaxherit | copë | 1 | 2440.00 | 970.00 | 1815.00 |

*Analiza e mësipërme është bazuar vetëm në krahasimin e çmimeve me ato të njësisë kërkuese të gjetura në platformën e-prokurimi. Hijezimet me të kuqe përfshijnë çmimet për të cilat AK kërkoi sqarime nga OE "Buqa" për çmime më të larta se ato të tregut, ndërsa komplet tabela përfshin çmimet të cilat Ak i konsideroi më të larta se ato të tregut nga AUTOTRADE SH.P.K. Analiza nuk përfshin verifikim të plotë të çmimeve të tregut apo burimeve alternative të furnizimit, duke lënë hapësirë për nevojën e një vlerësimi më të detajuar dhe gjithëpërfshirës nga AK.*

Eksperti shqyrtues sqaron se në vlerësimin fillestar, AK kërkoi sqarime nga OE "Buqa" për çmime më të larta se ato të tregut dhe pranoi arsyetimet e tij. Pas kthimit të lëndës për rivlerësim, AK kërkoi sqarime edhe nga AUTOTRADE SH.P.K., por nuk i pranoi përgjigjet e tij, pavarësisht se ankuesi kishte paraqitur dëshmi dhe kishte kërkuar verifikim nga përfaqësuesit e Toyota-s në rajon ose Evropë.
Kjo qasje e ndryshme në trajtimin e operatorëve ekonomikë mund të krijojë shqetësime lidhur me konzistencën dhe barazinë në vlerësimin e ofertave, në përputhje me Nenin 7 të LPP-së, i

cili thekson rëndësinë e trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues.
Sipas ekspertit shqyrtues vlerësimi i ofertave duhet të përfshijë si çmimet jonormalisht të ulëta, ashtu edhe ato të konsideruara të larta, duke garantuar një analizë objektive dhe të argumentuar. Kjo do të siguronte një proces vendimmarrjeje më të drejtë dhe të bazuar në të dhëna konkrete, duke shmangur çdo mundësi për vlerësim të njëanshëm ose jo të plotë të ofertave.
Në përputhje me Nenin 7 të LPP-së, procesi i vlerësimit duhet të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe të bazohet në analiza objektive.

**Pretendimi Ankimor 3**
Ankuesi pretendon se procesi i vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk është zhvilluar në përputhje me Nenin 59 të LPP-së, duke mos siguruar një shqyrtim të drejtë dhe objektiv të tenderëve. Për më tepër, nuk është respektuar kriteri kryesor për dhënien e kontratës, i cili kërkon që ajo t'i jepet operatorit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët, sipas Nenit 60, paragrafi 1.1 të LPP-së.
Gjithashtu, ankuesi thekson se anulimi i aktivitetit të prokurimit është kryer në kundërshtim me Nenin 62 të LPP-së, pasi nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në këtë dispozitë për justifikimin e një anulimi të tillë. Në bazë të këtyre shkeljeve, ai kërkon rishqyrtimin e procesit dhe rivlerësimin e ofertave në përputhje me kërkesat ligjore.
**Përgjigje në Pretendimin Ankimor 3**
Eksperti shqyrtues vlerëson se procesi i vlerësimit dhe krahasimit të ofertave duket të mos jetë zhvilluar plotësisht në përputhje me Nenin 59 të LPP-së, i cili kërkon një shqyrtim transparent dhe objektiv.
Po ashtu, kriteri për dhënien e kontratës operatorit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët, siç përcaktohet në Nenin 60, paragrafi 1.1 të LPP-së, duket se nuk është zbatuar në mënyrë të plotë, duke krijuar nevojën për një rivlerësim më të thelluar. Ndërkohë, anulimi i aktivitetit të prokurimit, pa argumente të qarta mbi përmbushjen e kushteve të Nenit 62 të LPP-së, krijon pasiguri lidhur me bazueshmërinë e këtij vendimi.
Duke marrë parasysh këto rrethana, eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor është i bazuar dhe rekomandon rishqyrtim të vendimit, duke siguruar një proces vlerësimi të drejtë dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

**Pretendimi Ankimor 4**
Ankuesi pretendon se vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është marrë brenda një afati jashtëzakonisht të shkurtër, duke ngritur shqetësime mbi seriozitetin dhe thellësinë e shqyrtimit. Sipas ankuesit, kërkesa për rishqyrtim është dorëzuar më 21.02.2025 dhe AK e ka refuzuar të njëjtën ditë, pa kryer një analizë të plotë.
Sipas tij shpejtësia e vendimmarrjes, në kontekstin e ngarkesës me procedura të tjera të prokurimit, mund të krijojë përshtypjen e një vendimi të paramenduar. Po ashtu, mungesa e një shpjegimi të detajuar mbi argumentet e ngritura në kërkesë e bën këtë vendim të paargumentuar dhe jo transparent.
**Përgjigje në Pretendimin Ankimor 4**
Eksperti shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar brenda afatit ligjor për tiu përgjigjur kërkesës për rishqyrtim, siç përcaktohet në Nenin 108/A, paragrafi 7 të LPP-së. AK ka refuzuar kërkesën në të njëjtën ditë, duke respektuar kufirin maksimal prej pesë (5) ditësh pune.
Fakti që përgjigja është dhënë brenda një kohe të shkurtër nuk përbën shkelje, por për të shmangur dyshimet mbi cilësinë e shqyrtimit, AK duhet të sigurojë analizë më të plotë dhe arsyetim më të detajuar për vendimet e saj.

Duke qenë se AK ka respektuar afatin ligjor, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar, por rekomandohet që AK të japë shpjegime më të plota në të ardhmen, për të garantuar një proces më transparent dhe të argumentuar.

**PËRFUNDIMI**

Eksperti shqyrtues rekomandon që ankesa e AUTOTRADE SH.P.K. të konsiderohet pjesërisht e bazuar dhe që lënda të kthehet në rivlerësim për një analizë më transparente dhe objektive, në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Ankesa mbështetet në mungesën e një trajtimi të barabartë mes operatorëve ekonomikë, pasi procesi i vlerësimit nuk është mbështetur në prova të qarta dhe të verifikueshme, duke krijuar pasiguri mbi objektivitetin dhe transparencën e vendimmarrjes. Gjithashtu, eliminimi i ofertës nuk është shoqëruar me një analizë të plotë të tregut, duke ndikuar në bazueshmërinë e këtij vendimi.

Megjithatë, pretendimi për shkelje të afateve në shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim nuk mbështetet, pasi AK ka vepruar brenda afatit ligjor të përcaktuar në LPP.

Në bazë të këtyre gjetjeve, eksperti shqyrtues rekomandon rivlerësimin e ofertave dhe sigurimin e një procesi të drejtë, objektiv dhe në përputhje me LPP-në.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" AUTOTRADE " SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

**Valmirë Deliu**